



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“KRIJIMI I INFRASTRUKTURËS DIDAKTIKE-MËSIMORE
DHE LABORATORIKE PËR ÇELJEN E PROGRAMIT
TË STUDIMIT BACHELOR NË
PËRKTHIMIN E GJUHËS SË SHENJAVE SHQIPE”**

**FINANCUAR NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
NË KUADËR TË NDËRKOMBËTARIZIMIT TË PROGRAMEVE TË
STUDIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT**



Ekipi i projektit:

Prof. Asoc. Dr. Anida KISI (koordinatore)

Anëtarë të personelit akademik:

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha
Prof. Dr. Eldina Nasufi
Prof. Asoc. Dr. Elona Toro
Prof. Asoc. Dr. Migena Alimehmeti
Dr. Bora Kuçuku

Prof. Asoc. Dr. Alba Frashëri
Dr. Drita Rira
Prof. Asoc. Dr. Klementina Shiba
Prof. Asoc. Dr. Lorena Dedja
Prof. Asoc. Dr. Fjoralba Dado

Anëtarë të personelit ndihmës-akademik:

Znj. Klodeta Alushani
Znj. Sema Hysa

Znj. Vasilika Mulla
Z. Dejan Kushta





FAZA 1: REALIZIMI I OBJEKTIVIT PËR ZHVILLIMIN INFRASTRUKTUROR



Më 22 shkurt 2024 u organizua aktiviteti mbi zhvillimet infrastrukturore të realizuara me projektin fitues të thirrjes për projekte nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit për vitin akademik 2022-2023, ku u zhvillua ceremonia e përrurimit të laboratorit të gjuhës së shenjave shqipe.

Në këtë aktivitet morën pjesë:

- Ministri i Arsimit dhe Sportit, Znj. Ogerta MANASTIRLIU;
- Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI, Znj. Mirela MUÇA;
- Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof. Dr. Artan HOXHA, me përfaqësues të tjerë të lartë të rektoratit;
- Dekani i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA dhe anëtarë të dekanatit të FGJH-së së bashku me personelin akademik e administrativ si edhe studentët e fakultetit.

Laboratori i ri do t'i shërbejë studentëve të ciklit të parë bachelor në interpretim të gjuhës së shenjave. Për herë të parë në Shqipëri dhe Ballkan do të nisë një program i ri, për të patur interpret të gjuhës së shenjave të diplomuar, një hap drejt arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës.



Ky laborator është pajisur me bazën e nevojshme materiale për përgatitjen e përkthyesve të gjuhës së shenjave dhe gjithashtu ka një infraskukturë TIK software me programe të përpunimit të videove dhe imazheve së bashku me aplikacione për mirëmbajtjen e tyre.



Në ceremoni u vu theksi tek rëndësia e këtyre projekteve infrastrukturore në shërbim të zhvillimit të kapaciteteve të infrastrukturës akademike, didaktike dhe kërkimore, të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit duke mundësuar realizimin e hulumtimeve dhe punëve kërkimore me standarde të larta, impaktit të drejtpërdrejtë që kanë këto investime teknologjike në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, inovacionit pedagogjik në mësimdhënie.

Ministri i Arsimit dhe Sportit, Znj. Manastirliu përgëzoi Dekanen dhe Rektorin për arritjet e deritanishme si edhe u shpreh se mbështetja e MAS-it dhe AKKSHI-t për IAL-të në drejtim të financimit të projekteve infrastrukturore dhe zhvillimore do të vijë gjithnjë e në rritje duke u mbështetur edhe në një dialog të vazhdueshëm për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme që lidhen me arsimin e lartë.



Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof. Dr. Artan HOXHA shprehu falënderimet për punën e kryer nga FGJH si edhe mbështetjen e vazhdueshme për të përkrahur nismat e FGJH-së në drejtim të digjitalizimit dhe ndërkombëtarizimit të programeve studimore.

Më poshtë foto të aktivitetit për përrurimin e laboratorit:











Realizimit të suksesshëm të këtij projekti iu bë një jehonë edhe në publikimet e bëra nga Ministria e Arsimit dhe Sportit znj. Ogerta Manastierliu.

link: <https://fb.watch/qNbGnzmbbM/>

Një zë i veçantë iu kushtua këtij aktiviteti në Televizionin A2 CNN, që është një kanal informativ në partneritet ekskluziv me kanalin ndërkombëtar informativ CNN, nën titullin: “Program studimor për gjuhën e shenjave, për herë të parë në Shqipëri e Ballkan”.

link: <https://www.youtube.com/watch?v=3Kfwj-cVf2A>

Gjithashtu, publikime të rëndësishme mbi këtë aktivitet u pasqyruan në web zyrtar dhe rrjetet sociale të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.